



BULETIN INFORMATIV

PRILL - QERSHOR 2025

Athinë, ERRU nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi me Rregullatorin Grek (RAAEY)

Në 18 Qershor, Enti Rregullator i Ujit (ERRU) nënshkroi në Athinë Memorandum Mirëkuptimi me Autoritetin Rregullator Grek për Energjinë, Mbetjet dhe Ujin (RAAEY), duke vendosur themelet e një bashkëpunimi strategjik dhe afatgjatë në fushën e rregullimit të sektorit të ujit.

Memorandumi u nënshkrua nga Znj. Gerta Lubonja, Kryetar i ERRU, dhe Z. Athanassios Dagoumas, President i RAAEY, të cilët theksuan angazhimin e institucioneve që drejtojnë në përbashkëtimin e sfidave të përbashkëta, krijimin e një kuadri të qëndrueshëm për shkëmbimin e njohurive, për projekte të përbashkëta, zhvillimin e kapaciteteve si dhe përmirësimin e performancës së shërbimeve të ujit.

Memorandumi përfshin shkëmbim të përvojave, njohurive dhe praktikave më të mira në fushën e politikave rregullatore, tarifimit dhe monitorimit të performancës; zhvillim të përbashkët të kapaciteteve përmes trajnimeve, vizitave studimore dhe projekteve të përbashkëta; bashkëpunim në nismat kërkimore dhe teknologjike, me fokus në cilësinë e shërbimit, mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurinë e furnizimit me ujë; koordinim për prezantime të përbashkëta në platforma ndërkombëtare dhe programe europiane.

Ky memorandum nuk është vetëm një akt formal, por një hap konkret drejt rritjes së efikasitetit rregullator, forcimit të transparencës dhe përmbushjes së objektivave afatgjata në përputhje me standardet e BE.

PËRMBAJTJA

- MARRËVESHJA ERRU & RAAEY
- VENDIMET E KKRR
- KONFERENCA
- TAKIME PUNE
- EVENTE TË NDRYSHME



Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit

VENDIMMARRJA E KKRR

Në tre mujorin e dytë të vitit 2025, nga muaji prill deri në qershor, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU ka zhvilluar disa mbledhje, në të cilat ka miratuar tetë vendime, midis të cilëve veçohen:

- ✓ Vendim “Për shtyrje afati për miratimin e tarifave të shërbimit për Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat sh.a”
- ✓ Vendim “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr.43, datë 08.11.2024 ‘Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Vlorë’”
- ✓ Vendim “Për shtyrje afati për miratimin e tarifave të shërbimit për Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a”
- ✓ Vendim “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr.5, datë 22.02.2023 ‘Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a ”
- ✓ Vendim “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator “Për detajimin e planit të shpenzimeve operative të ERRU për vitin 2025”

LICENCA

Në sektorin e ujit operojnë aktualisht 17 shoqëri ujësjiellës kanalizime, 14 prej të cilave të licencuara si shoqëri rajonale: Shoqëria Rajonale UK Durrës, Lezhë, Korçë, Kukës, Gjirokastrë, Berat, Fier, Lushnjë, Pogradec, Elbasan, Sarandë, Dibër, Shkodër, Vlorë dhe 3 shoqëri të tjera UK: Tiranë, Vorë, Kamëz. Në tre mujorin e dytë të vitit 2025, pranë ERRU janë paraqitur dhe kanë marrë aprovim kërkesat për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor nga Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Tiranë dhe Vlorë.

TARIFA

Në 3-mujorin e dytë të vitit 2025, Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) ka marrë në shqyrtim dhe është në procesin final të miratimit të tarifave për tre shoqëri: Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat, Korçë dhe Elbasan. Miratimi i propozimeve të ardhura nga këto shoqëri e çon në nëntë numrin e shoqërive rajonale që operojnë me tarifa të reja që pas reformimit të sektorit të ujit, të nisur në fillim të vitit 2022. Por më parë, nevojitet mendimi i Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës Kanalizimeve, bashkive përkatëse, dhe Autoritetit të Konkurrencës.

PJESËMARRJA NË KONFERENCA

Asambleja e Përgjithshme e WAREG, ERRU merr pjesë në mbledhjen e 35-të

Në datat 18 dhe 19 qershor u zhvilluan punimet e Asamblesë së Përgjithshme të 35-të të WAREG (Shoqatës Evropiane të Rregullatorëve të Ujit) në Athinë, në të cilën mori pjesë edhe Enti Rregullator i Ujit, si anëtare me të drejta të plota.

përfaqësues nga ERRU u bënë pjesë aktive në diskutimet mbi qëndrueshmërinë e ujit gjatë ndërprerjeve të energjisë; Diskutime mbi tarifat, performancën dhe përmirësimin e shërbimeve; Iniciativa për të vendosur më shumë përgjegjësi te ndotësit industrialë; Përgatitjet mbi eventet e ardhshme evropiane, si Forumi për Rregullimin e Ujit në Bruksel. Si vendi pritës i Asamblesë, pjesë e axhendës ishte edhe përvoja e Greqisë në



rregullimin e sektorit të ujit, me të cilin ERRU nënshkroi edhe një Memorandum Mirëkuptimi. Enti Rregullator i Ujit i sheh këto takime si mundësi për të mësuar, për të ndarë përvoja dhe për të sjellë standarde më të larta në rregullimin e sektorit të ujit në Shqipëri.



Një grup pune nga Enti Rregullator i Ujit mori pjesë në seminarin dyditor më 27 - 28 Maj, të organizuar nga Programi TAIEX i BE, në bashkëpunim me Shoqatën Evropiane të Rregullatorëve të Ujit (WAREG) dhe ERRU. Ky aktivitet mbledhi mbi 30 përfaqësues institucionale dhe rregullatorë nga vendet e rajonit dhe më gjerë për të diskutuar praktikën e mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave, me qëllim për të përcaktuar më tej Treguesit Kryesorë të Performancës përmes të cilave do të

Programi TAIEX i BE, seminar mbi saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave në sektorin e ujit

monitorohet performanca e shërbimeve të ujit. Gjatë punimeve të seminarit u trajtuan çështje thelbësore si: rëndësia e të dhënave të sakta dhe të besueshme për vendimmarrje rregullatore; metodologjitë për vlerësimin dhe verifikimin e të dhënave; përdorimi i sistemeve të automatizuara për raportim dhe kontroll të brendshëm; përcaktimi dhe zbatimi i treguesve kryesorë të performancës (KPI).

Vjenë, ERRU pjesë e Konferencës Vjetore të Danubit për Ujin

Nga data 12 deri më 16 maj 2025, në Vjenë u mbajtën dy aktivitete madhore për sektorin e ujit: *Vienna Water Knowledge Flow* dhe *Danube Water Conference 2025*, organizuar nga Programi i Danubit për Ujin dhe mbështetur nga Banka Botërore dhe Qeveria Austriake. Në të dy aktivitetet e zhvilluara gjatë kësaj jave, Enti Rregullator i Ujit u përfaqësua nga Z. Genci Gjeci, Anëtar i Komisionit Kombëtar Rregullator dhe Znj. Nevila Saliu, Përgjegjëse e Sektorit Ekonomik dhe Tarifave në ERRU, e cila mbajti dy prezantime në lidhje me: Rregullimin e sektorit të ujit në Shqipëri; Eksperienca me shoqëritë e agreguara. Ky angazhim rikonfirmon përkushtimin e ERRU për të ndjekur standardet më të mira ndërkombëtare dhe për të kontribuar në zhvillimin e sektorit të ujit në rajon.



TAKIME PUNE

Pogradec, ERRU takim pune të përbashkët me Rregullatorin e Kosovës, ARRU



Në kuadër të bashkëpunimit me Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit në Kosovë (ARRU) Enti Rregullator i Ujit zhvilloi një takim tre ditor (nga data 23-25 prill) në Pogradec për të diskutuar çështje kyçe të sektorit të ujit.

Grupe pune nga ERRU & ARRU, udhëhequr nga kryetarët Znj. Gerta Lubonja dhe Znj. Hajrie Morina sollën në tryezën e diskutimeve tema konkrete dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e shërbimeve të ujit:

Performanca dhe besueshmëria e të dhënave

- Impakti i rajonalizimit të Përmirësimi i treguesve të Performancës në Shqipëri;
- Monitorimi dhe auditimi vjetor i performancës së shoqërive rajonale UK në Kosovë.

Procesi tarifar

- Menaxhimi financiar i shoqërive UK;
- Metodologjia e vendosjes së tarifave në Kosovë;
- Diskutim mbi tarifat e qëndrueshme për investime në infrastrukturë.

Standardet e shërbimit dhe trajtimi i ankesave

- Rruga drejt digjitalizimit të raportimit të shërbimeve të ujit;
 - Diskutim mbi sfidat dhe përvojat nga ERRU & ARRU
- Pjesëmarrja e Komisionit Rregullator për Shërbimet e Ujit në Maqedoni (ERC) shtoi më tej vlerën e bashkëpunimit.

Ky takim konsolidon urat ndërrajonale midis rregullatorëve, duke hapur rrugën për zgjidhje inovative e qëndrueshmëri në sektorin e ujit.



Vizitë studimore në ITUN Korçë dhe Pogradec

Përfaqësues nga Rregullatorët e Ujit në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni e Veriut (ERRU, ARRU, ERC) zhvilluan një vizitë pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjetës Kanalizime Korçë për t'u njohur me ecurinë e kësaj shoqërie, arritjet dhe sfidat e hasura, duke nënvizuar rëndësinë e përmirësimit të Treguesve të Performancës dhe ofrimit të shërbimeve cilësore për konsumatorët. Vizita përfshiu edhe inspektimin e Impianteve të Trajtimit të Ujërave të Ndotura në Korçë dhe Pogradec, ku pjesëmarrësit u njohën me proceset biologjike të pastrimit të ujërave, teknologjitë moderne të riciklimit dhe përdorimin e llumit të trajtuar si fertilizues në bujqësi. Znj. Gerta Lubonja, Kryetar i ERRU përgëzoi UKR Korçë si një model suksesi në sektorin e ujit, për efikasitetin, shërbimet cilësore dhe menaxhimin efikas të burimeve. Ndërsa kreu i UKR Korçë, Z. Petrit Tare vlerësoi qasjen pozitive të ERRU-së në procesin e agregimit të shoqërisë, e njëkohësisht implementimin e metodologjisë së tarifave duke theksuar rëndësinë e rolit mbështetës të Entit për forcimin e sektorit të ujit. Ky takim thekson rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për ndërtimin e një sektori uji më inovativ, më të fortë dhe më të qëndrueshëm për të ardhmen!

EVENTE TË NDRYSHME

Menaxhimi i burimeve njerëzore në sektorin UK, ERRU në takim in e dytë ndërinstytucional

Në prill, ERRU mori pjesë në takimin e dytë ndërinstytucional për menaxhimin e burimeve njerëzore në sektorin UK, organizuar në Tiranë nga Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), në kuadër të projektit RCDN. Aty u diskutuan prioritetet sektoriale, u miratua Plani Vjetor i Punës dhe nisën përgatitjen e Dokumentit të Pozicionimit – hapa konkretë këto për të forcuar kapacitetet në sektor. Përfaqësues nga shoqëritë UK, Shoqata për Autonomi Vendore dhe SHUKALB sollën ide dhe angazhim për një të ardhme më të qëndrueshme.



Dita Botërore e Mjedisit, stafi i ERRU trajnim me prof. Enkelejda Gjinali

Në Ditën Botërore të Mjedisit, 5 Qershor stafi i ERRU zhvilloi një trajnim të posaçëm me Prof. Asoc. Enkelejda Gjinali mbi përmirësimin e shërbimeve të ujit dhe kanalizimeve, sfidat mjedisore, si dhe përpunjen me standardet evropiane në kuadër të Kapitullit 27 të Direktivës Evropiane të Ujit për Konsum Publik. Në thelb: Sektori i ujit përbën një shtyllë bazë për mbrojtjen e mjedisit; Legjislacioni evropian përcakton qasje të integruar për cilësinë e ujit dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Ky trajnim përbën një hap të rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve të stafit dhe përmirësimin e objektivave.



“Espid4Vjosa”, ERRU pjesë e konferencës përmbyllëse të projektit

Në kuadër të konferencës përmbyllëse të projektit ESPID4Vjosa Znj. Gerta Lubonja, Kryetar i Entit Rregullator të Ujit, moderoi panelin me temë: “Menaxhimi i integruar i ujërave: Zhvillimi i planeve të menaxhimit të ujërave”. Diskutimet sollën në fokus nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse dhe ndërkufitare në administrimin e burimeve ujore, duke nxitur dialogun mes institucioneve, komuniteteve dhe aktorëve ndërkombëtarë. Konferenca shërbeu si një platformë për të ndarë arritjet, për të nxitur bashkëpunime të reja dhe për të përcaktuar hapat e ardhshëm drejt një të ardhmeje të qëndrueshme të Vjosës dhe burimeve të saj ujore.



Enti Rregullator i Ujit në terren për cilësinë e ujit

Në kuadër të projektit “Active Water II”, Enti Rregullator i Ujit u bë pjesë e një bashkëpunimi të rëndësishëm për mbrojtjen e burimeve ujore dhe forcimin e transparencës. Më 18 dhe 24 Qershor 2025, H2H Foundation, në bashkëpunim me ERRU, Agjencinë e Mbrojtjes së Burimeve Ujore, Art Kontakt dhe North Green Association realizoi matje të parametrave fiziko-kimikë në terren dhe u morën kampione për analiza bakterologjike, me qëllim vlerësimin e cilësisë së ujit në disa pika të Hidrovorit Hamallaj dhe Liqenit të Bovillës. Këto aktivitete shënuan një bashkëpunim të suksesshëm për të forcuar transparencën, koordinimin dhe mbrojtjen e burimeve ujore në rajon. Gjatë monitorimit u zhvillua edhe një takim me përfaqësues të UKT-së, ku diskutuam mungesën e tabelave informuese që ndalojnë larjen, hedhjen e mbeturinave apo futjen e personave të paautorizuar dhe kafshëve në këtë zonë me rëndësi për furnizimin me ujë.



Rr: "Viktor Eftimiu", Ndërtesa 1,
Kati IV, Njësia Administrative
Nr. 5, 1022, Tiranë, Shqipëri



TEL:
+355 42 258 046



EMAIL:
public@erru.al